



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 3606 prot

Vlorë, 20.02.2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

**“PËR MIRATIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE KRITEREVE TË CILAT DO TË
APLIKOHET SHËRBIMI I PARKIMIT ME PAGESË”**

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 89, datë 22.11.2022 “Për policinë bashkiake”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 96, datë 23.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për bashkinë Vlorë, viti 2024”, i ndryshuar, relacionit të dorëzuar me shkresën nr. 21461 prot., datë 24.12.2025 nga grupi i punës së ngritur me urdhërin e brendshëm nr. 409, datë 07.10.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në territorin e bashkisë Vlorë” i ndryshuar me urdhërin e brendshëm nr. 366, datë 31.07.2025 “Për shtesa dhe ndryshimin në urdhërin e brendshëm nr.409 datë 07.10.2024”, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës _____ 2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e rrugëve dhe shesheve të destinuara për parkim me pagesë, sipas listës së mëposhtme dhe hartave bashkëlidhur (Aneksi 1):
 - a. Rrugët, tarifa, koeficienti i shfrytëzimit dhe fasha orare, në të cilat do të aplikohet shërbimi i parkimit me pagesë, janë:

Nr	Rruga	Vendet e parkimit	Koeficienti i shfrytëzimit në %	Tarifa lekë/orë
1	Bulevardi "Ismail Qemali" (Riviera- Xhamia)	248	78.1	50
2	"Sheshi i Flamurit"	22	62.5	50
3	"Demokracia"	123	81.2	50
4	"Fejzo Gjomema"	55	81.2	50
5	"Gjergj Kastrioti"	399	84.4	50
6	"Pelivan Leskaj"	66	56.2	50
7	"Hasan Kushta"	87	78.1	50
8	"Gjergj Arianiti"	80	78.1	50
9	Fushat e sportit lungomare	20	87.5	50
10	"Sulejman Delvina" (Nga Gjykata -Prefektura)	23	62.5	50
11	"Haziz Xhyheri" (te Taushani)	13	62.5	50
12	"Veledin Kollozi"	50	62.5	50
13	"Hektor Shyti"	26	81.2	50
14	"Pavlo Flloko"	5	62.5	50
15	"Meno Gjoleka"	32	78.1	50
16	"Ibrahim Abdulla" (afër hotel Primavera)	16	78.1	50
17	"Rushit Gorishova"	28	62.5	50
18	"Meno Gjoleka" (Te C Front)	20	62.5	50
19	"Aleksander Moisiu"	72	81.2	50
20	"Wilson" (te rrapi)	7	87.5	50

- kohëzgjatja (ditët dhe oraret e qëndrimit) e parkimit me pagesë në rrugë do të jetë si më poshtë:

Gjatë periudhës së sezonit turistik:

15 maj – 15 shtator,
ora 08:00 – 20:00
e hënë – e djelë

Gjatë periudhës jashtë sezonit turistik:

16 shtator – 14 maj:
ora 08:00 – 18:00
e hënë – e premte


- b. Sheshet tarifa, koeficienti i shfrytëzimit dhe fasha orare, në të cilat do të aplikohet shërbimi i parkimit me pagesë, janë:

Nr.	Sheshet	Vendet e parkimit
1	Sheshi tek Stadiumi "Flamurtari"	144
2	Sheshi në unazën 2 "Lungomare"	96
3	Sheshi tek fushat e sportit në pyllin e Sodës	125

Nr.	Tarifa sipas intervalit të qëndrimit në sheshe	Niveli i tarifës lekë
1	0 deri 10 minuta	Falas
2	0-1 orë	50
3	0 -2 orë	100
4	2 - 5 orë	200
5	5 – 8 orë	300
6	8 – 12 orë	400
7	12 – 24 orë	500

4. Implementimi i shërbimit të parkimit me pagesë të pilotohet në disa rrugë dhe sheshe, sipas një grafiku të hartuar nga bashkia Vlorë.
5. Miratimin e parkimit pa pagesë për rezidentët, në hapësirat publike midis pallateve në të gjithë territorin administrativ të bashkisë Vlorë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Vlorë dhe Administrata e Shoqëria “Vlora Parking”, sh.a.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 3606 Prot

Vlorë, më 20.07 2026

Lënda: Përcjellje Relacioni “Për miratimin e rrugëve, shesheve dhe kritereve të cilat do të aplikohet shërbimi i parkimit me pagesë”.

KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Në vijim të Projekt Vendimit “Për miratimin e rrugëve, shesheve dhe kritereve të cilat do të aplikohet shërbimi i parkimit me pagesë”, bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion *Relacionin e paraqitur nga grupi i punës i cili është angazhuar dhe ka kryer detyrat respektive brenda kompetencave të tyre në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 366, datë 31.07.2025, me lëndë: “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në territorin e Bashkisë Vlorë.*

Për sa më sipër, në mbështetje të kuadrit ligjor dhe kompetencave të Bashkisë Vlorë, i kërkojmë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimmarrës miratimin e relacionit “Për miratimin e rrugëve, shesheve dhe kritereve të cilat do të aplikohet shërbimi i parkimit me pagesë”.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

KRYETAR
Brunilda Mersini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

RELACION

“Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në territorin e Bashkisë Vlorë”

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. QËLLIMI I RELACIONIT**
- II. KRONOLOGJIA E PUNËS NË TERREN**
- III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT**
- IV. VLERËSIMI I RRUGËVE TË STUDIARA**
- V. SHESHET PUBLIKE**
- VI. PËRFUNDIME DHE KOMENTE**

- Sara Zhapa- anëtar
- Skerdilajd Hunda-anëtar
- Besi Gjondeda-anëtar
- Manuela Prifti- anëtar
- Donald Leskaj-anëtar
- Bledar Toja-anëtar

Në këtë mbledhje u diskutua mes të gjithë anëtarëve sipas njohurive dhe kompetencave përkatëse, materialeve në dispozicion dhe shembujve të rasteve analoge të bashkive të tjera. Duke u bazuar në gjithë diskutimet dhe materialet në dispozicion, për të përcaktuar metodologjinë e ndjekur për realizimin e studimit sipas fazave të nevojshme, u bë ndarja e detyrave për secilin prej anëtarëve. Po ashtu, u rishikuan rrugët dhe zonat konkrete ku do të kryhej evidentimi i qarkullimit të automjeteve, parkimi aktual dhe analiza e mundësive për shndërrimin e tyre në zona parkimi me pagesë sipas zonave të ndarjes gjeografike në pesë rajonet e qytetit të Vlorës.

Më datë 27.08.2025, ora 09:00, grupi i punës, sipas planifikimit u mbledh tek zona e Ujit të Ftohtë ku u bë shpërndarja në rrugët e propozuara të përcaktuara sipas rajoneve 1,2,3,4,5. Grupet u angazhuan për të kryer një vëzhgim të qarkullimit të automjeteve në orare të ndryshme gjatë ditës. Gjatë këtij procesi u vëzhgua fluksi i qarkullimit aktual në orare të ndryshme të ditës sipas fashave orare, mënyra e përdorimit të hapësirave ekzistuese për parkim, parametrat e rrugëve kryesore dhe dytësore si dhe problematikat që lidhen me ngarkesën e trafikut dhe mungesën e vendeve të dedikuara për parkim. Më pas sipas përcaktimeve të grupit të punës u kryen vëzhgime dhe në oraret e drekës dhe darkës ku trafiku konsiderohet me një fluks të lartë.

Më datë 28.08.2025, ora 09:00, grupi i punës u mbledh në pikën e takimit pranë Bulevardit “Vlorë–Skelë”. Puna në terren vijoi me matjen dhe evidentimin e trafikut në rrugët dhe zonat e mëposhtme:

- Bulevardi “Vlorë–Skelë”
- Rruga “Gjergj Araniti”
- Rruga “Hasan Kushta”
- Zona përreth Stadiumit “Flamurtari”

Gjatë këtij procesi u krye vëzhgimi i qarkullimit në disa intervale kohore, me qëllim që të përcaktohen oraret e ngarkesës maksimale dhe fleksibiliteti i këtyre akseve rrugore në raport me parkimin publik.

Më datë 29.08.2025, ora 09:00, pika e takimit u përcaktua tek Rruga “Fejzo Gjomema”, e cila u mor në shqyrtim së bashku me Rrugën “Gjergj Kastrioti”. Përgjatë këtij inspektimi u krye matja e fluksit të lëvizjes së mjeteve dhe u analizuan mundësitë që ofrojnë këto rrugë për përshtatjen në

Për koeficientin 4 pikë është marrë si referencë mesi i intervalit të sipërm, vlera 87.5%.

- Ky koeficient përkthehet më pas në numrin optimal të vendeve për parkim me pagesë që një rrugë mund të ofrojë.
- **Formula:** Mesatarja = $(P1+P2+P3+P4)/4 \rightarrow$ Koeficienti i mes.aritmetike .
- Koefcenti i shfrytëzimit në % X numrin total të vëndeve = me numrin e vendeve për shfrytëzim parkimi.

Shembull përlllogaritjeje të nr.vendeve për shfrytezim parkimi, për një rrugë të caktuar.

Kriteri I- 3p, Kriteri II- 4p, Kriteri III- 4p, Kriteri IV- 2p.

$3p+4p+4p+2p=13p$ totali $\rightarrow$ Mesatarja.aritmetike.pikëzimit= $13p/4=3.25p$ për rrugën e dhënë.

Konvertimi i kësaj mesatare të pikëzimit në koeficient shfrytëzimi të shprehur në %.

$3.25p \rightarrow 75\% + 3.1\% = 78.1\%$ (3.25p i përket intervalit 75-100% dhe 0.25p i përket 3.1%)

IV. VLERËSIMI I RRUGËVE TË STUDIARA

- **Bulevardi “Ismail Qemali” (Rrethrrrotullimi i Skelës- Xhamia)**

Bulevardi “Ismail Qemali” është një nga rrugët kryesore dhe më të rëndësishme të qytetit. Kjo rrugë ndodhet në qendër të qytetit dhe shërben si një arterie kryesore që lidh pjesën qendrore të qytetit me zonat e tjera. Në këtë rrugë ndodhen institucione arsimore, shëndetësore, banka të nivelit të dytë, biznese në një numër të konsiderueshëm me veprimtari të ndryshme. Ky bulevard përmban të gjitha elementët e infrastrukturës urbane modern si: trotuare të gjerë, gjelbërim, hapësirë të mjaftueshme parkimi etj.... Kjo rrugë gjatë gjithë vitit ka një fluks të lartë të trafikut, numër të lartë turistësh dhe banorësh duke qenë se qyteti i Vlorës është një nga destinacionet bregdetare më të rëndësishme dhe të frekuentuar.

10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme vlerësuar sipas Tabelë nr.2:

- Pikët: $4 + 4 + 4 + 1 = 13$
- Mesatarja: 3.25
- Koeficienti: 78.1%
- Vendet totale: 318
- Vendet me pagesë: 248


Tabelë nr.2

I Vendodhja		Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II Qëllimi zones		Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	
III Fluksi ditor		Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
		shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
		shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
		shfrytëzim normal	2	
		shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi		Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
		Mundësi e mirë parkimi	3	
		Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
		Mundësi e pakët parkimi	1	1

Kjo zonë është e investuar me hapësira pedonale, gjelbërim dhe element urban dhe përfshin edhe zonën e Qendrës Historike e kthyer tashmë në një atraksion turistik si një ndër projektet më të bukura, investuar në vitet e fundit, Qendra Digjitale në fazë punimesh etj. Përreth kësaj zone gjenden bare, restorante, njësi akomoduese, banka të nivelit të dytë dhe institucioni i Bashkisë Vlorë.

Me investimet e kryera kjo zonë shërben si qendër funksionale urbane që lidhet me Bulevardin “Ismail Qemali” dhe zonat e tjera përreth.

Pamje Harta -Sheshi i Flamurit



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.3

Nr.	Emërtimi i rrugës	“Sheshi i Flamurit”
1	Gjatësia e aksit rrugor	340 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane kryesore- Kategoria D
3	Numri i vendparkimeve	37
4	Parkime me pagesë	36

	shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
	Mundësi e mirë parkimi	3	
	Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	2
	Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 2 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.2 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 29.08.2025, Ora 08:00



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.5

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga "Demokracia"
1	Gjatësia e aksit rrugor	600 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane kryesore- Kategoria D
3	Numri i vendparkimeve	163
4	Parkime me pagesë	152 <i>(92 poste krahu perëndimor dhe 60 poste krahu lindor)</i>
5	Parkime Taksi	8
6	Parkime PAK	3
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	2 krahë
8	Koeficienti i shfrytëzimit	81.2%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme vlerësuar sipas Tabelë nr.6:

- Pikët: $4 + 3 + 4 + 3 = 14$
- Mesatarja: 3.5
- Koeficienti: 81.2%
- Vendet totale: 152
- Vendet me pagesë: 123

Aneks nr.3 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 01.09.2025, Ora 10:00 dhe 14:00



3	Numri i vendparkimeve	84
4	Parkime me pagesë	68 <i>(35 poste krahu verior dhe 33 poste krahu perëndimor)</i>
5	Parkime Taksi	14
6	Parkime PAK	2
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	2 krahë
8	Koeficienti i shfrytëzimit	81.2%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme vlerësuar sipas Tabelë nr.8:

- Pikët: $4 + 4 + 4 + 2 = 14$
- Mesatarja: 3.5
- Koeficienti: 81.2%
- Vendet totale: 68
- Vendet me pagesë: 55


Tabelë nr.8

I	Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II	Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	

- **Rruga “Gjergj Kastrioti” – (Rruga Transballkanike)**

Kjo rrugë përfshin numrin më të lartë të vend parkimeve të përfshira në projektin e Bashkisë Vlorë për shërbimin e parkimit me pagesë. Gjatë kësaj rruge preken tre njësi administrative, 3, 4 dhe 5, duke filluar nga rreth rrotullimi në Hyrje të qytetit të Vlorës e përfundon tek Rreth rrotullimi i fundit që të lidh me rrugën “ Fejzo Gjomemo’ . Është një nga rrugët me shpeshtësi qarkullimi automjesh të lartë për vetë pozicionin gjeografik që ajo ka. Përgjatë kësaj rruge ndodhen një numër i lartë biznesesh me veprimtari të ndryshme tregëtare. Përveç bizneseve, gjatë këtij aksi rrugor gjenden edhe institucione shtetërore të ndryshme. Kjo rrugë shërben për të lidhur edhe qytetin me rrugë të tjera apo blloqe banimi. Gjatë viteve të fundit në këtë rrugë janë kryer investime duke e klasifikuar këtë rrugë në akset që përfshihen të gjitha elementët urban, si trotuare, gjelbërim, ndriçim. Gjithashtu kjo rrugë është rruga më e gjerë e qytetit e ndarë me trafik ndarës në dy pjesë me dy korsi lëvizjeje dhe mundësi të lehtë parkimi.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “Gjergj Kastrioti”



Tabelë nr.10

I	Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II	Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	
III	Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
		shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
		shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
		shfrytëzim normal	2	
		shfrytëzim i ulët	1	
IV	Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
		Mundësi e mirë parkimi	3	3
		Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
		Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 5 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “Pelivan Leskaj”



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.11

Nr.	Emërtimi i rrugës	“Rruga Pelivan Leskaj”
1	Gjatësia e aksit rrugor	950 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane kryesore- Kategoria D
3	Numri i vendparkimeve	120
4	Parkime me pagesë	118
5	Parkime Taksi	0
6	Parkime PAK	2

	shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
	Mundësi e mirë parkimi	3	3
	Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
	Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 6, të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.5 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 23.08.2025, Ora 08:30 dhe 14:00



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.13

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga "Hasan Kushta"
1	Gjatësia e aksit rrugor	480 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane dytësore- Kategoria E
3	Numri i vendparkimeve	117
4	Parkime me pagesë	112 (56 poste krahu verior (B); 56 poste krahu jugor (A))
5	Parkime Taksi	2 (krahu verior)
6	Parkime PAK	3 (1 post krahu verior (B); 2 poste krahu jugor (A))
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	2 krahë
8	Kalim për biçikleta	2 krahë
9	Koeficienti i shfrytëzimit	78.1%
10	Tarifa	50 lekë/ora
11	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 08:00 deri 18:00
12	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kriterëve të mëposhtme:

- Pikët: $3 + 3 + 4 + 3 = 13$
- Mesatarja: 3.25
- Koeficienti: 78.1%
- Vendet totale: 112
- Vendet me pagesë: 87

Aneks nr.6 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 28.08.2025, Ora 09:30 dhe 12:00



- **Rruga “Gjergj Araniti”**

Rruga “Gjergj Araniti” e njohur si rruga e Çipajve ndodhet në një nga zonat më të rëndësishme të qytetit, kjo rrugë siguron lidhje funksionale midis zonave rezidenciale dhe akseve kryesore të qytetit. Rruga është investuar me asfaltim, ndricim, gjelbërim, trotuare. Gjatë kësaj rruge gjenden institucione arsimore si dhe biznese me veprimtari të ndryshme tregëtare. Kjo rrugë ka një

8	Koeficienti i shfrytëzimit	78.1%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme:

- Pikët: $4 + 3 + 4 + 2 = 13$
- Mesatarja: 3.25
- Koeficienti: 78.1%
- Vendet totale: 103
- Vendet me pagesë: 80

Tabelë nr.16


I Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
	Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
	Rrugë terciare	2	
	Rrugë periferike	1	
II Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Portuale-turistike	4	
	zonë tregëtare	3	3
	Institucione	2	
	Banimi	1	
III Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
	shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
	shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
	shfrytëzim normal	2	
	shfrytëzim i ulët	1	



- **Fushat e Sportit në “Lungomare”**

Kjo zonë përbën një kompleks publik rekreativ i ndodhur në fund të projektit Lungomare I, në një nga zonat më të frekuentuara me një prej peisazheve më të bukur turistik. Investimi i kryer në këtë zonë ka transformuar zonën në një hapësirë modern për vizitorët dhe qytetarët. Investimet e kryera në këtë zonë kanë rritur ndjeshëm numrin e bizneseve në fushën e hotelerisë, bare dhe restorante.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Fushat e Sportit në “Lungomare”



II Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Portuale-turistike	4	4
	zonë tregëtare	3	
	Institucione	2	
	Banimi	1	
III Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
	shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
	shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
	shfrytëzim normal	2	
	shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Mundësi shumë e mirë parkimi	4	4
	Mundësi e mirë parkimi	3	
	Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
	Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 8 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.8 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 28.08.2025, Ora 12:00, 19:00





Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.19

Nr.	Emërtimi i rrugës	RRUGA "SULEJMAN DELVINA"(NGA GJYKATA TE PREFEKTURA)
1	Gjatësia e aksit rrugor	0.27 km
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane kryesore- Kategoria D
3	Numri i vendparkimeve	39
4	Parkime me pagesë	38
5	Parkime Taksi	0
6	Parkime PAK	1
7	Drejtimi i lëvizjes, kahu i lejuar i parkimit	1 kahë
8	Koeficienti i shfrytëzimit	62.5%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare:	- 08:00 deri 20:00

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 9 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.9 – Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 28.08.2025, Ora 09:00, 12:00, 18:00



• **Rruga “Haziz Xhyheri”**

5	Parkime Taksi	4
6	Parkime PAK	1
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	1 kah
8	Koeficienti i shfrytëzimit	62.5%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kriterëve të mëposhtme:

- Pikët: $3 + 4 + 4 + 1 = 12$
- Mesatarja: 3
- Koeficienti: 62.5%
- Vendet totale: 21
- Vendet me pagesë: 13

Tabelë nr.22

I	Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	3
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II	Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	
III	Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
		shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
		shfrytëzim i lartë i rrugës	3	

- **Rruga “Veledin Kollozi”**

Rruga ndodhet në aksin që lidh Bulevardin “Ismail Qemali” deri tek kryqëzimi me rrugën “Misto Mele”. Kjo rrugë është e investuar me të gjitha elementët urban, trotuare, ndricim, gjelbërim. Gjatë kësaj rruge ndodhen biznese të ndryshme dhe kjo rrugë shërben për lidhjen e lagjeve të ndryshme me rrugët kryesore të qytetit.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “Veledin Kollozi”



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.23

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga “Veledin Kollozi”
1	Gjatësia e aksit rrugor	323 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane kryesore- Kategoria D
3	Numri i vendparkimeve	85
4	Parkime me pagesë	81 (45 poste kahu verior dhe 36 poste kahu jugor)
5	Parkime Taksi	3
6	Parkime PAK	1

Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
Mundësi e mirë parkimi	3	
Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	2
Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 11 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.11– Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 29.08.2025, Ora 10:00



6	Parkime PAK	-
7	Drejtimi i lëvizjes, kahu i lejuar i parkimit	2 kah / 1kah
8	Koeficienti i shfrytëzimit	81.2%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kriterëve të mëposhtme:

- Pikët: $4 + 4 + 4 + 2 = 14$
- Mesatarja: 3.5
- Koeficienti: 81.2%
- Vendet totale: 33
- Vendet me pagesë: 26


Tabelë nr.26

I Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
	Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
	Rrugë terciare	2	
	Rrugë periferike	1	
II Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Portuale-turistike	4	4
	zonë tregëtare	3	
	Institucione	2	
	Banimi	1	
III Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
	shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
	shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
	shfrytëzim normal	2	
	shfrytëzim i ulët	1	

- **Rruga “Pavlo Flloko”**

Rruga ndodhet në zonën e Ujit të Ftohtë dhe është një nga rrugicat që lidh Bulevardin e Bregdetit me rrugën e Unazës ‘ Dhimtër Konomi ‘ dhe del në rrugën “Francesko Krispi “. Kjo rrugë ka përreth biznese hotelerie dhe objekti banimi.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “ Pavlo Flloko”



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.27

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga “Pavlo Flloko”
1	Gjatësia e aksit rrugor	76.6 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë lokale – Kategoria F
3	Numri i vendparkimeve	9 (vende nga njëra anë e rrugës)
4	Parkime me pagesë	9
5	Parkime Taksi	0
6	Parkime PAK	0

Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
Mundësi e pakët parkimi	1	1

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 13 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.13– Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 01.09.2025, Ora 12:00



4	Parkime me pagesë	42 (22 vende ana veriore (A); 20 vende ana jugor (B))
5	Parkime Taksi	3 (ana veriore)
6	Parkime PAK	1 (ana jugore (B))
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	2 kahe
8	Koeficienti i shfrytëzimit	78.1%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kriterëve të mëposhtme:

- Pikët: $3 + 4 + 4 + 2 = 13$
- Mesatarja: 3.25
- Koeficienti: 78.1%
- Vendet totale: 42
- Vendet me pagesë: 32


Tabelë nr.30

I Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	
	Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	3
	Rrugë terciare	2	
	Rrugë periferike	1	
II Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Portuale-turistike	4	4
	zonë tregëtare	3	
	Institucione	2	
	Banimi	1	

- **Rruga “Ibrahim Abdulla”**

Kjo rrugë ndodhet afër hotel Primavera dhe përfshin zonë me qarkullim të lartë mjetesh sidomos në periudhën e sezonit turistik. Në afërsi të rrugës ka një numër të konsiderueshëm biznesesh dhe objekte banimi.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “Ibrahim Abdulla”



Të gjithë elementët e domosdoshëm për tu aplikuar në shërbimin e parkimit me pagesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr.31

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga “Rreshat Osmani”
1	Gjatësia e aksit rrugor	185 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë urbane dytësore- Kategoria E
3	Numri i vendparkimeve	24
4	Parkime me pagesë	21 (22 poste krahu verior);
5	Parkime Taksi	2 (krahu verior)
6	Parkime PAK	1 (1 post krahu verior)

	shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Mundësi shumë e mirë parkimi	4	
	Mundësi e mirë parkimi	3	
	Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	2
	Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 15 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.15– Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 27.08.2025, Ora 14:30



Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga “Rushit Gurishova”
1	Gjatësia e aksit rrugor	170 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë Lokale F.
3	Numri i vendparkimeve	47
4	Parkime me pagesë	45 (22 poste krahu verior);
5	Parkime Taksi	Nuk ka
6	Parkime PAK	2 (1 post krahu verior) (1 post krahu jugor)
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	1 krahë
8	Koeficienti i shfrytëzimit	62.5%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme:

- Pikët: $3 + 4 + 4 + 1 = 12$
- Mesatarja: 3
- Koeficienti: 62.5%
- Vendet totale: 45
- Vendet me pagesë: 28

Tabelë nr.34

I Vendodhja		Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	3
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II Qëllimi zones		Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	



- **Rruga “Meno Gjoleka”**

Kjo rrugë ndodhet në zonën e Ujit të Ftohtë, paralel me rrugët “Rushit Gurishova” dhe “Ibrahim Abdulla” e cila fillon në Shëtitoren e Bregdetit dhe del në rrugën e unazës. Zona përfshin njësi akomoduese, bare dhe restaurante.

Tabelë nr.35

Nr.	Emërtimi i rrugës	Rruga “Mëno Gjoleka” tek C Front
1	Gjatësia e aksit rrugor	120 m
2	Kategoria e rrugës	Rrugë Lokale E
3	Numri i vendparkimeve	34
4	Parkime me pagesë	33
5	Parkime Taksi	Nuk ka
6	Parkime PAK	1
7	Drejtimi i lëvizjes, krahu i lejuar i parkimit	2 krahë
8	Koeficienti i shfrytëzimit	62.5%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare:	- 08:00 deri 20:00

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 17 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.

Aneks nr.17– Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 27.08.2025, Ora 10:00



3	Numri i vendparkimeve	91
4	Parkime me pagesë	89
5	Parkime Taksi	-
6	Parkime PAK	2
7	Drejtimi i lëvizjes, kahu i lejuar i parkimit	1kah / 1kah
8	Koeficienti i shfrytëzimit	81.2%
9	Tarifa	50 lekë/ora
10	Fasha orare: - gjatë sezonit turistik - jashtë sezonit turistik	- 08:00 deri 20:00 - 08:00 deri 18:00
11	Ditët e tarifimit: - gjatë sezonit - jashtë sezonit	- E hënë - e djelë - E hënë - e premte

Koeficienti i shfrytëzimit sipas kritereve të mëposhtme:

- Pikët: $4 + 4 + 4 + 2 = 14$
- Mesatarja: 3.5
- Koeficienti: 81.2%
- Vendet totale: 89
- Vendet me pagesë: 72

Tabelë nr.38

I	Vendodhja	Rëndësia e rrugës: Vlerësimi 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Rrugë kryesore që lidhin qendrat urbane	4	4
		Rrugë me lidhje direkte me rrugët kryesore	3	
		Rrugë terciare	2	
		Rrugë periferike	1	
II	Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
		Portuale-turistike	4	4
		zonë tregëtare	3	
		Institucione	2	
		Banimi	1	
III	Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
		shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
		shfrytëzim i lartë i rrugës	3	



- **Rruga “Wilson”**

Rruga ndodhet në Ujë të Ftohtë tek zona e Rrapit. Janë përfshirë një numër i vogël post parkimesh sikurse tregohet edhe në tabelën e mëposhtme. Në këtë rrugë ka njësi biznesi dhe njësi akomoduese.

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit - Rruga “Wilson



II Qëllimi zones	Kategoria e rezidencës: vlerësimi nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Portuale-turistike	4	4
	zonë tregëtare	3	
	Institucione	2	
	Banimi	1	
III Fluksi ditor	Shkalla e përdorimit për parkimet e rrugës 1-4	Pikët	Vlerësimi
	shfrytëzim i plotë i rrugës	4	4
	shfrytëzim i lartë i rrugës	3	
	shfrytëzim normal	2	
	shfrytëzim i ulët	1	
IV Akses parkimi	Shkalla e lehtësisë për parkim nga 1-4	Pikët	Vlerësimi
	Mundësi shumë e mirë parkimi	4	4
	Mundësi e mirë parkimi	3	
	Mundësi parkimi mjaftueshëm	2	
	Mundësi e pakët parkimi	1	

Gjatë vëzhgimeve dhe verifikimeve në terren në orë të ndryshme janë kryer edhe disa foto- Aneks 19 , të cilat tregojnë vendet e parkimeve të zëna nga automjete. Sjellim në vëmendje se vëzhgimi është bërë vetëm në muajin Gusht që përkon edhe me fluksin e lartë të vizitorëve të huaj edhe vendas, por edhe qytetarë të Vlorës.


Aneks nr.19– Foto gjatë kryerjes së vëzhgimit datë Datë 25.08.2025, Ora 19:30, 19:54



V- SHESHET PUBLIKE

• SHESHI TEK FUSHAT E SPORTIT NË PYLLIN E SODËS


Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit



Tabelë nr.41


Nr.	Emërtimi	Parkimi tek fushat e sportit në pyllin e Sodës
1	Numri i vendparkimeve	125
2	Parkime me pagesë	125
3	Parkime PAK	4
4	Ditët e tarifimit:	E hënë – E diel

Pamje nga Harta e Projektit i Propozuar i Parkimit



Tabelë nr.42

Nr.	Emërtimi	Sheshi në unazën 2 "Lungomare".
1	Numri i vendparkimeve	96
2	Parkime me pagesë	96
3	Parkime PAK	2
4	Ditët e tarifimit:	E hënë - të djelën



Aneks nr.22– Foto nga vend parkimi



Niveli i tarifave në sheshet publike referuar edhe bashkive të tjera propozojmë të jenë si më poshtë:

Tabelë nr.44

Nr.	Tarifa sipas intervalit të qëndrimit në sheshe	Niveli i tarifës
1	0 deri 10 minuta	Falas
2	0-1 orë	50 lekë/ora
3	0-2 orë	100 lekë/ora
4	0-5 orë	200 lekë/ora
5	5 - 8 orë	300 lekë/ora
6	8 – 12 orë	400 lekë/ora
7	12 – 24 orë	500 lekë/ora



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES
SEKTORI I MENAXHIMIT TË E-KËRKESAVE DHE E-ANKESAVE

Nr. 3658 prot.

Vlorë, më 23.02.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

DATË 20.02.2026 ORA 11:00

Tema: Konsultim publik për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në territorin e Bashkisë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Vlorë-z. Novruz Rrokaj, Nënkryetar i Bashkisë – z. Ilir Hasani, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetarët e Rajonove, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

Takimin e hapi Nënkryetar i Bashkisë Vlorë-z. Ilir Hasani: Përshëndetje, Dëgjesa është “Për Miratimin e Rugëve, Shesheve dhe Kriteret për të Cilat do të Aplikohet Shërbimi i Parkimeve me Pagesë” me qëllim vendosjen e parkimit me pagesë i cili do të kontribuojë ndjeshëm në lehtësimin e trafikut rrugor në qytetin e Vlorës.

Në veçanti në akset kryesore të qytetit, kjo nismë do të lehtësojë problematikën e keqmenaxhimit të parkimeve abuzive, ku mjetet qëndrojnë të parkuara për një kohë të gjatë. Si Bashki kemi përgatitur një relacion shpjegues, ku do të sqarojnë drejtoritë përkatëse. Pas prezantimit do të jemi në një bashkëbisedim të hapur.

Z. Krisat Jorgaqi, Drejtor i Infrastrukturës: Përshëndetje, ky studim është bërë nga një grup multidisiplinor, i cili ka përfshirë urbanistë, arkitektë, inxhinierë, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Taksave dhe kryetarë të rajoneve. Gjatë vëzhgimit në terren janë vlerësuar disa indikatorë, si fluksi i qarkullimit sipas fashave të ndryshme orare, mënyra e përdorimit të hapësirave, duke ndjekur edhe praktikatat e tjera që janë zbatuar në qytete të tjera ku është aplikuar parkimi me pagesë. Janë marrë në konsideratë katër kritere bazë: vendndodhja e

rrugës, qëllimi i zonës, fluksi ditor i mjeteve, si dhe aksesimi për parkim. Janë përfshirë rrugët kryesore dhe tre sheshe.

VLERËSIMI I RRUGËVE TË STUDIUARA

Bulevardi “Ismail Qemali” (Rrethrotullimi i Skelës- Xhamia)

Sheshi i Flamurit

-Rruga Demokracia (Rruga e Re)

-Rruga “Fejzo Gjomema”- (Rruga Kosova)

-Rruga “Gjergj Kastrioti” – (Rruga Transballkanike) ---

-Rruga “Pelivan Leskaj”

-Rruga “Hasan Kushta”

-Rruga “Gjergj Araniti”

-Fushat e Sportit në “Lungomare”

-Rruga “Sulejman Delvina”

-Rruga “Haziz Xhyheri”

- Rruga “Veledin Kollozi”

-Rruga “Hektor Shyti”

-Rruga “Pavlo Flloko”

-Rruga “Meno Gjoleka”

-Rruga “Ibrahim Abdulla”

-Rruga “Rushit Gorishova”

-Rruga “Meno Gjoleka”

-Rruga “Aleksander Moisiu”

-Rruga “Wilson”

-SHESHET PUBLIKE, SHESHI TEK FUSHAT E SPORTIT NË PYLLIN E SODËS

-SHESHI NË UNAZËN 2 LUNGO MARE

-SHESHI TE STADIUMI FLAMURTARI

Z. Inqli Xhaferaj, Drejtor i Urbanistikës: Përsëritet, Ja disa planvendosje të rrugëve ku propozohet parkimi me pagesë.

Kemi Bulevardin “Ismail Qemali”:

Numri i vendparkimeve: 37

Parkime me pagesë: 36

Parkime Taksi: 0

Parkime për persona me aftësi të kufizuar (PAK): 1

Rruga Demokracia (Rruga e Re)

Numri i vendparkimeve: 163

Parkime me pagesë: 152 (92 poste krahu perëndimor dhe 60 poste krahu lindor)

Parkime Taksi: 8

Parkime PAK: 3

Rruga “Fejzo Gjomema”- (Rruga Kosova)

Numri i vendparkimeve: 84

Parkime me pagesë: 68 (35 poste krahu verior dhe 33 poste krahu perëndimor)

Parkime Taksi: 14

Parkime PAK: 2

Rruga “Gjergj Kastrioti” – (Rruga Transballkanike)

Numri i vendparkimeve: 494

Parkime me pagesë: 473 (241 poste krahë perëndimor dhe 232 poste krahë lindor)

Parkime Taksi: 13

Parkime PAK: 8

Rruga “Pelivan Leskaj”

Numri i vendparkimeve: 120

Parkime me pagesë: 118

Parkime Taksi: 0 nuk ka

Parkime PAK: 2

Rruga “Hasan Kushta”

Numri i vendparkimeve: 117

Parkime me pagesë: 112 (56 poste krahë verior (B); 56 poste krahë jugor (A))

Parkime Taksi: 2 (krahë verior)

Parkime PAK: 3 (1 post krahë verior (B); 2 poste krahë jugor (A))

Rruga “Gjergj Araniti”

Numri i vendparkimeve: 108

Parkime me pagesë: 103 (58 poste krahë verior (B); 45 poste krahë jugor (A))

Parkime Taksi: 2 (1 post krahë verior (B); 1 post krahë jugor (A))

Parkime PAK: 3 (1 post krahë verior (B); 2 poste krahë jugor (A))

Fushat e Sportit në “Lungomare”

Numri i vendparkimeve: 23

Parkime me pagesë: 23

Parkime Taksi – nuk ka

Parkime PAK: 1

Rruga “Sulejman Delvina”

Numri i vendparkimeve: 39

Parkime me pagesë: 38

Parkime Taksi: 0

Parkime PAK: 1

Rruga “Haziz Xhyheri”

Numri i vendparkimeve: 26 (vende nga njëra anë e rrugës)

Parkime me pagesë: 21

Parkime Taksi: 4

Parkime PAK: 1

Rruga “Veledin Kollozi”

Numri i vendparkimeve: 85

Parkime me pagesë: 81 (45 poste krahë verior dhe 36 poste krahë jugor)

Parkime Taksi: 3

Parkime PAK: 1

Rruga “Hektor Shyti”

Numri i vendparkimeve: 36

Parkime me pagesë: 33 (23 poste krahë perëndimor dhe 10 poste krahë lindor)

Parkime Taksi: 3

Parkime PAK – nuk ka

Rruga “Pavlo Flloko”

Numri i vendparkimeve: 9 (vende nga njëra anë e rrugës)

Parkime me pagesë: 9

Parkime Taksi: 0

Parkime PAK: 0

Rruga “Meno Gjoleka”

Numri i vendparkimeve: 46 (vendparkime nga të dyja anët)

Parkime me pagesë: 42 (22 vende ana veriore (A); 20 vende ana jugor (B))

Parkime Taksi: 3 (ana veriore)

Parkime PAK: 1 (ana jugore (B))

Rruga “Ibrahim Abdulla”

Numri i vendparkimeve: 24

Parkime me pagesë: 21 (22 poste krahu verior);

Parkime Taksi: 2 (krahu verior)

Parkime PAK: 1 (1 post krahu verior)

Rruga “Rushit Gorishova”

Numri i vendparkimeve: 47

Parkime me pagesë: 45 (22 poste krahu verior);

Parkime Taksi Nuk ka

Parkime PAK: 2 (1 post krahu verior) (1 post krahu jugor)

Rruga “Meno Gjoleka”

Numri i vendparkimeve: 34

Parkime me pagesë: 33

Parkime Taksi Nuk ka

Parkime PAK: 1

Rruga “Aleksander Moisiu”

Numri i vendparkimeve: 91

Parkime me pagesë: 89

Parkime Taksi -

Parkime PAK: 2

Rruga “Wilson”

Numri i vendparkimeve: 9

Parkime me pagesë: 8

Parkime Taksi -

Parkime PAK: 1

SHESHI TEK FUSHAT E SPORTIT NË PYLLIN E SODËS

Numri i vendparkimeve: 125

Parkime me pagesë: 125

Parkime PAK: 4

SHESHI NË UNAZËN 2 "LUNGO MARE".

Numri i vendparkimeve: 96

Parkime me pagesë: 96

Parkime PAK: 2

SHESHI TE STADIUMI "FLAMURTARI"

Numri i vendparkimeve: $109 A + 35 B + 8 PAK = 152$ TOTAL

Parkime me pagesë: 144

Parkime PAK: 8

Z. Krisat Jorgaqi, Drejtor i Infrastrukturës, Për sa i përket sezonit turistik, nga data 15 maj deri më 15 shtator, oraret do të jenë nga ora 08:00 e mëngjesit deri në orën 20:00 të darkës, nga e hëna në të diel. Ndërsa jashtë sezonit turistik, orari do të jetë nga ora 08:00 e mëngjesit deri në orën 18:00, nga e hëna në të premte. Për sa i përket pagesës, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak, datë 07.12.2023, tarifa është 50 lekë për orë.

Ndërsa për sheshet aplikohet pagesë progresive:

nga 0 deri në 1 orë – 50 lekë të reja,

nga 1 deri në 2 orë – 100 lekë të reja,

nga 2 deri në 5 orë – 300 lekë të reja,

nga 8 deri në 12 orë – 400 lekë të reja,

nga 12 deri në 24 orë – 500 lekë të reja.

Këto janë tarifat dhe oraret e përcaktuara.

Banor: Përshëndetje, banoj te Stacioni i Trenit, Rajoni 4. Jam dakord me parkimin, por kemi një problem me rrugën. Ju lutem na e shtroni rrugën dhe më pas bëni parkimin.

Z. Ilir Hasani: E kemi një projekt për zonën e Stacionit të Trenit.

Z. Agim Aliu, banor i lagjes "1 Maji": Siç është rruga "Miss Durham", mendoj që edhe atje të aplikohet një zgjidhje tjetër: kur parkimi bëhet në një krah të rrugës, për një muaj të parkohet majtas dhe muajin tjetër djathtas. Sepse kur parkohen makina në të dyja anët e rrugës, vështirësohet shumë kalimi.

Banor: Koeficienti i numrit të parkimeve për personat me aftësi të kufizuar mendoj se është shumë i ulët. Sipas standardeve të Bashkimit Europian, duhet të jenë dy vende për persona me aftësi të kufizuar për çdo 50 vende parkimi me pagesë. Gjithashtu, nuk dëgjova të parashikohen vende për gratë shtatzëna dhe për familjet me fëmijë deri në dy vjeç. Po ashtu, duhet të parashikohet edhe një vendqëndrim për shkarkimin e mallrave të bizneseve, pa pagesë.

Z. Kristaq Jorgaqi, Drejtor i Infrastrukturës: Për sa i përket pikave të para, sigurisht që do të rishikohen për të përmbushur normat e Bashkimit Europian dhe do të diskutohen sërish me grupin e punës. Dua të sqaroj pikën e fundit në lidhje me bizneset. Të gjitha bizneset që kanë nevojë për furnizim me mallra pajisen me një autorizim nga sektori përkatës, në bazë të kërkesës së tyre. Po përgatitet një rregullore ku, gjatë sezonit turistik, furnizimi do të jetë më i kufizuar, zakonisht pas orës 10:00 dhe pas orës 12:00.

Banor: Cilat janë gjokat që aplikohen në rast penalteti? A do të ketë tolerancë, nëse paguan për një orë dhe vonohesh vetëm 5 minuta?

Znj. Axhiola Bozhani, Drejtoreshë Vlorë Parking:

Për sa i përket mënyrave të pagesës, kemi parashikuar metoda gjithëpërfshirëse, me qëllim që çdo qytetar të ketë akses në këtë shërbim të Bashkisë Vlorë. Platforma që do të implementohet ofron disa mundësi:

Pagesa me mesazh – ku parashikohet targa e automjetit. Kjo është pagesë e menjëhershme dhe automatike, që nuk kërkon aplikacion.

Përmes aplikacionit elektronik – bëhet regjistrimi i targës dhe pagesa kryhet me kartë krediti. Kontrollon historiku i të gjitha pagesave. Metoda tradicionale me bileta të printuara – për personat që nuk përdorin teknologji:

Përdoruesi blen biletën pranë pikës së autorizuar ose operatorit në terren.

Zgjedh kohëzgjatjen e parkimit sipas tarifës. Vendos biletën në pjesën e dukshme të xhamit të përparmë të automjetit. Inspektori verifikon vlefshmërinë e saj gjatë kontrollit.

Bileta tregon orën e fillimit dhe kohën e përfundimit të parkimit. Ky do të jetë një shërbim shumë i nevojshëm për qytetin tonë.

Z. Sejmen Gjokoli: Qarkullimi dhe parkimi në qytet është emergjencë, pasi ka problem me qarkullimin e ambulancave. Duhet të hapen rrugë paralele nëpër lagje, që parkimi të mos përqendrohet vetëm në bulevardin Vlorë-Skele ose Transballkanik. A është menduar një vendparkim për autobusët turistikë? Ndoshta ka hapësira nëpër lagje. Mendoj për një parkim të tillë tek rruga “Kosova”. Kam besim tek ju.

Faleminderit!

Z. Ilir Hasani: Faleminderit! Do përpiqemi maksimalisht të bëjmë më të mirën e mundshme. E kemi marrë këtë detyrë me përgjegjësi të plotë, duke dhënë një model konkret të qasjes ndaj problematikave. Propozimi juaj do të merret në konsideratë. Kjo nismë është marrë në kuadër të fillimit të një praktike që me kalimin e kohës do të përmirësohet, dhe dëgjesa ka pikërisht këtë qëllim.

Z. Kristaq Jorgaqi: Siç e tha edhe nënkryetari, qëllimi i dëgjesave është që edhe mangësitë që konstatohen të merren në konsideratë. I drejtë është konstatimi që në këto parkime nuk janë përfshirë autobusët turistikë. Me grupin e punës do të diskutohet sërish për të parë mundësinë e përfshirjes së tyre.

Z. Taulant Kondi, Drejtori i Policisë Bashkiake: Në çdo rrugë parkohen makinat elektrike dhe taksitë, dhe ka karikues në çdo cep të rrugëve. Kush do t’i paguajë këto shpenzime?

Z. Niko Dumani, Përfaqësues nga Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit Natyror: Jam njojtur me relacionin. Numri i makinave të qytetit të Vlorës, në dijeninë time, është 29,000. Sa është shpejtësia mesatare e lëvizjes së makinave në rrugët kryesore? Duhet hapur një rotondo te ish-Shtëpia e Oficerëve dhe te sheshi i Gjykatës së Vjetër/Transballkanike. Bashkia duhet të anulohet lejet e parkimit privat në truall publik, përfshirë edhe trotualet.

Banor: Të shtrohen njëherë të gjitha rrugët, pastaj të mendohet për parkimet. Po për ne, rezidentët, a Qytetar: Të shtrohen njëherë të gjitha rrugët, pastaj të mendohet për parkimet. Po për ne, rezidentët, a do të mendohet? Faleminderit, kaq kisha!

Z. Ilir Hasani: Puna për rezidentët është menduar, prandaj u organizua edhe kjo dëgjese, që qëllimi të marrë formë. Duam të fillojmë procesin, dhe në hapin tjetër është parashikuar edhe shqetësimi juaj për krijimin e zonave për rezidentët, sidomos gjatë sezonit turistik, kur është e pamundur të parkosh poshtë shtëpisë.

Znj. Axhiola Bozhani: E kuptojmë shqetësimin. Padiskutim, me anë të kësaj dëgjese do të shqyrtojmë të gjitha këto problematika. Jemi në procesin e përgatitjes së një rregulloreje, ku do të përfshihen të gjitha këto çështje, që të shqyrtohen dhe miratohen, duke pasur një impakt pozitiv për banorët e Vlorës.



Z. Novrus Rrokaj: Gjej rastin t'ju falenderoj të gjithëve! Mendoj se ia arritëm qëllimit, duke marrë vërejtjet dhe sugjerimet nga qytetarët. Më pas, administrata e Bashkisë do ta rishikojë materialin duke marrë parasysh edhe sugjerimet tuaja, dhe pastaj do të vijë në Këshill. Në fund, Këshilli vendos.

Z. Pëllumb Nezha: të vendosim kufizues në pallatet te Plazhi i Vjetër.

Z. Ilir Hasani: Nuk mund të bëjmë diferencime, pasi nëse bëhet kjo lind një problem tjetër.

Z. Kristaq Jorgaqi: Për sa i përket pjesës së parkimeve të subjekteve që kanë lidhur kontrata me Bashkinë Vlorë, të gjitha këto kontrata janë lidhur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike me afat njëvjeçar. Deri në mbarimin e kësaj kontrate, në vijim është menduar që shoqëria Vlora Parking, e cila do të merret me menaxhimin e parkimit me pagesë, duhet të shqyrtojë edhe këtë pjesë dhe ta çojë në vendimmarrjen e shoqërisë.

Z. Ilir Hasani: Faleminderit!

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultimin Publik
Audora Kamberaj